

Nr. 2313/Pz  
Dt. 23.11.17



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

**URDHËR**

161557,

Nr. 148 Datë 21.11.17

**PËR**

**SISTEMIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË "ALBCONTROL" SHA TIRANË**

**DREJTUAR: SHOQËRISË "ALBCONTROL" SHA TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 " Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare ", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Urdhrit Nr.4869/1, datë 6.7.2016, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë " Albcontrol" Sha Tiranë;

**URDHËROJ:**

1. Kapitali themeltar të zvogëlohet për vlerën 81,552,202 lekë, i barabartë me 81,552.2 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
2. Kapitali themeltar të zmadhohet për vlerën 742,379,131 lekë, i barabartë me 742,379.1 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila.
3. Kapitali Themeltar i shoqërisë bëhet 5,679,172,000 lekë, i barabartë me 5,679,172 aksione me vlerë nominale 1000 lekë secila. Diferenca prej 929 lekë kalon në rezervë ligjore.
4. Këto ndryshime të bëhen në aktet e themelimit të shoqërisë.
5. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit " ngarkohet Drejtoria e shoqërisë "Albcontrol" Sha Tiranë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**  
  
**Arbën Ahmetaj**



Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr 3; Tiranë, Albania; [www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al); [info@financa.gov.al](mailto:info@financa.gov.al)



*e njëjti me origjinalin*

Nr. prot. 21

Tiranë 02/11/2017

**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

Nr. 14, datë 02/11/2017

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT “PËR SISTEMIMIN E KAPITALIT TË  
REGJISTRUAR TË SHOQËRISË “ALBCONTROL” SHA, TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 167, pika 1, nenit 154, pika 1 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore” (i ndryshuar); udhëzimit nr.394, datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror”; kreut IV, pika 5, shkronja “a” të udhëzimit të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës nr.318, datë 08.04.2009 për “Emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”; nenit 23, pika 2, shkronja “g”/i, dhe shkronja “h” të Statutit të shoqërisë “ALBCONTROL” SHA, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Mbikëqyrës,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë sistemimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë “ALBCONTROL” SHA, sipas vlerave të referuara në raportin e ekspertës kontabël të emëruar nga aksionari.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “ALBCONTROL” SHA, të marrë masa për vijimin e procedurave të mëtejshme pranë aksionarit të shoqërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**GENCLIGJONÇAJ**

**KRYETAR**